



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:177787

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01531960

PKR.nr.238/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i trupit gjykues me pjesëmarrjen e Sekretares Juridike procesmbajtësen Nushe Kadrija, në lëndën penale kundër të akuzuarve M. Xh. B. nga fshati . . ., Komuna Deçan, për shkak të veprës penale: përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-se, dhe të akuzuarit E. H. Xh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-se, të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë –Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr. 153/2020, të datës 23.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 12.02.2021 në prezencën e Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të akuzuarve, **me datë 12.02.2021** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.02.2021 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.M. B., i biri i Xh. e ëma F., e gjinisë T., data e lindjes . . . në Deçan, me vendbanim në fshatin . . ., Komuna e Deçanit, i martuar, atë i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion gastronom, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

2.E. XH., i biri i H.it, e ëma A., e gjinisë H., data e lindjes . . . në Gjakovë, ku edhe tani jeton në rrugën “. . .”, beqar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion biznes privat, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

..

J A N Ë F A J T O R

Për shkak se:

I akuzuari M. B.:

I.Më parë ka siguruar dhe me datë 10.10.2020 rreth orës 23:00/h, në Gjakovë, pikërisht tek sheshi “. . .”, ka përdorur pistoletën me gaz me numër serik A398993, model 088-9 kalibri 9 mm, prodhimi Gjerman, ngjyrë hiri dhe dorëz të zezë, me kundërshtim me nenin 18 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Armë të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që natën kritike i pandehuri kishte shkuar në lokalin “. . .” së bashku me shokët e tij ku qëndron disa orë dhe kur del nga lokali e nxjerr pistoletën me gaz dhe gjuan 3 (tri) herë në ajër, e më pas e takon të pandehurin E. Xh., i cili ia kërkoj pistoletën me gaz ku i njëjti ia falë.

-Me këto veprime ka vepër penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-se.

I akuzuari E. Xh.,

II. Pasi më parë ka siguruar dhe me datën 10.10.2020 rreth orës 23:30 minuta, në Gjakovë, pikërisht tek sheshi “. . .”, ka përdorur pistoletën me gaz me numër serik A398993, model 088-9 kalibri 9 mm, prodhimi Gjerman, ngjyrë hiri dhe dorëz të zezë, me kundërshtim me nenin 18 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Armë të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që natën kritike i pandehuri kishte shkuar në lokalit “. . .” së bashku me shokët e tij ku qëndron disa orë dhe kur del nga lokali e nxjerr pistoletën me gaz të cilën paraprakisht i ka falur M. B. dhe e gjuan 3 (tri) herë në ajër, e më pas largohet në drejtim të shtëpisë së tij.

-Me këto veprime ka vepër penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-se.

III. Më par ka siguruar dhe gjerë me datën 10.10.2020, në Gjakovë, pikërisht tek sheshi “. . .”, pa autorizim , ka poseduar armë dhe municion në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për Armë të Republikës së Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë të ndaluara dhe atë me një (1) armë pistoletë me gaz, numër serik A398993, model 088-9 kalibri 9 mm, prodhimi Gjerman, ngjyrë hiri dhe dorëz të zezë, në atë mënyrë që ditën kritike pas një informate se kishte të shtëna me armë tek lokali “. . .”, policia ka dalë në vendin e ngjarjes ku ka gjetur dhe sekuestruar tre (3) gëzhoja dhe gjatë kontrollës nga zyrtarët policor të stacionit policor në Gjakovë, në shtëpinë e të pandehurit pikërisht në dhomën në kacën metalike të mbyllur me çelës kanë gjetur dhe sekuestruar armën e lartcekur.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale: mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paaautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe nenit 366 par.1, nenit 367 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 dhe 366 te KPPK-se, të akuzuarit i :

G J Y K O N

Të akuzuarin M. B., për dispozitivin I të akuzës për veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se, **ME DENIM ME KUSHT** duke i a vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej **2 (dy) viteve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

Të akuzuarin E. Xh. për dispozitivin II të akuzës për veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se, **ME DENIM ME KUSHT** duke i a vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej **2 (dy) viteve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale. **Për dispozitivin III të akuzës**, për veprë penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-se, **ME DENIM ME GJOBË** në shume prej katërqind (400) €, të cilin dënim duhet ta paguaj në afate prej tredhjet (30) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të behet i formës së prere.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobe, atëherë Gjykata të akuzuarit ja zëvendëson dënimin me gjobe në dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëzet (20) dite, duke llogaritur çdo ditë të kaluar në burgim nga 20 €.

Ndaj të akuzuarit E. Xh. i **konfiskohet**: pistoletën me gaz me numër serik A398993, model 088-9 kalibri 9 mm, prodhimi Gjerman, ngjyrë hiri dhe dorëz të zezë, si objekte të veprës penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armës të konfiskuar, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2020-EA-118.

Detyrohen të akuzuarit, që t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë secili veç e veç në shumë prej tridhjetë (30) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm tani Departamentit për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën me numër PP .nr. 153/2020, të datës 23.12.2020, kundër të akuzuarve M. B. nga fshati . . ., Komuna Deçan, për shkak të veprës penale: përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-se, dhe të akuzuarit E. Xh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-se.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestare me datë 12.02.2022, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala si dhe të akuzuarit M. B. dhe E. Xh..

Pas leximit të aktakuzës në seancën e shqyrtimit fillestarë, Gjykata është bindur se të akuzuarit kanë kuptuar aktakuzën, iu është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë, kështu që pas shpjegimeve të bëra nga Kryetari i Trupit Gjykoese, të akuzuarit kanë deklaruar se: e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen,

I akuzuari i parë M. B. duke dhënë mendim për pranimin e fajësisë deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe shton se pistoletën që e kam përdorë kam gjuajtur në ajër ku nuk ka pasur persona tjerë, kurrkënd nuk e kam rrezikuar dhe nuk kam ditur që arma me gaz është e ndaluar, shprehi keqardhjen dhe i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë të paraparë me ligj, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale.

I pandehuri i dytë E. Xh. duke dhënë mendim për pranimin e fajësisë deklaroi se pranoi fajësinë për dy veprat penale që më vihen në barrë sipas aktakuzës, shprehi keqardhje për rastin, por nuk kam ditur që pistoletën me gaz është e ndaluar me ligj, kreken nuk e kam rrezikuar andaj i propozoi gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat, pranimin e fajësisë dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale.

Pas deklarimit të akuzuarve M. B. dhe E. Xh., për pranimin e fajësisë, Kryetari i trupit gjykoës kërkoi që mendimin e vet ta jep Prokurori i Shtetit.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala duke dhënë mendim për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve pasi që të njëjtit kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e kanë bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në prova në të cilat bazohet aktakuza dhe për këto arsye i propozoi gjykatës që të aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykoës pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykoës konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykoës ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari M. d B., me dashje ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se, në kohën, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv I të këtij Aktgjykimi.

Se i pandehuri E. Xh. , me dashje ka kryer veprat, përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-se, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv II dhe III të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 367 paragrafi 1 te KPRK-se, është parashikuar se formën themelore te veprës penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm kryhet: “ *kush do qe përdor arme apo materiale plasëse ne kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiale plasëse te tilla, dënohet me burgim prej 1 (një) deri ne 8 (tete) vjet.*

Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarin M. B., e ka shpallur fajtor për veprat penale nen dispozitivin I, për të cilën është ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par 1 te KPRK-se, ndërsa të akuzuarin E. Xh., e ka shpallur fajtor për veprat penale nën dispozitivin II dhe III, për të cilat është ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprave penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 ar.1 te KPRK-se dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: se të akuzuarit janë të moshës së re, në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar për veprat penale për të cilat ngarkohen, si dhe faktin se më parë nuk kanë qenë të dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarit, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitivet e këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 te KPRK-së dhe se dënimet e shqiptuara me kusht dhe gjobe sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon të akuzuarit dhe se me dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi konfiskimin e armës

Gjykata ndaj të akuzuarit E. Xh. nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, ka konfiskuar amën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si objekt i veprës penale dhe më pas ka urdhëruar Stacionin Policorë në Gjakovë që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armës.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
PKR.nr.238/20, me datë 23.02.2021

Sekretare juridike,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.